



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 04 REGJISTRI TË PARAQITUR NË KQZ
NGA PARTIA ALEANCA ARBNORE KOMBËTARE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 29.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

KËRKUES: Partia "Aleanca Arbënore Kombëtare"

OBJEKT: Kundërshtimi i Vendimit nr.10 datë 22.05.2019 të KZAZ nr.68 "Për mosregjistrimin e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Maliq".

BAZË LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68; 72 73; 124, 143, pika 1, gërma "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e palëve,

VËREN

Partia Aleanca Arbënore Kombëtare ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr.04, datë 29.05.2019, me objekt "Kundërshtimi i Vendimit nr.10, datë 22.05.2019, të KZAZ nr. 68 "Për mosregjistrimin e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Maliq propozuar nga subjekti politik Partia Aleanca Arbënore Kombëtare, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën e datës 29.05.2019, ora 10:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr.04 regj., sipas objektit të sipërcituar.



Në mbledhjen e datës 29.05.2019, KQZ përpara nisjes së hetimit administrativ në mbështetje të nenit 135, pika 3 verifikoi legjitimitetin e palëve dhe konstatoi se për ankimin nr. 04 subjekti ankues i vetëm, është Partia Aleanca Arbënore Kombëtare. Referuar pikës 1, neni 124 ankuesi është brenda afati ligjor të paraqitjes së ankesës.

- Pala ankuese në ankimin e paraqitur në datë 29.05.2019 pretendon se:

Me vendimin nr.10, datë 22.05.2019, të KZAZ nr. 68, Bashkia Maliq, ka vendosur mosregjistrimi e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Maliq, propozuar nga subjekti Aleanca Arbënore Kombëtare, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.

1. Subjekti zgjedhor Partia Aleanca Arbënore Kombëtare më datë 13.05.2019 me nr.8 prot., ka depozituar kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Maliq, pranë KZAZ-së dhe me shkresën me nr. 3361 prot., datë, 13.05.2019 ka paraqitur pranë KQZ-së modelin nr. 13 dhe formularët e vetdeklarimit për kandidatët për anëtar në këshillin e bashkisë Maliq.
 2. Me shkresën me nr. 18 prot., datë 18.05.2019, të KZAZ nr. 68, Bashkia Maliq, ka njoftuar subjektin zgjedhor AAK për konstatimin e mangësive.
 3. Subjekti zgjedhor Partia Aleanca Arbënore Kombëtare me shkresën nr.20 prot., datë 20.05.2019 dhe me shkresëm me nr. 32 prot., datë 22.05.2019 ka dërguar në KZAZ-në nr. 68 plotësimin e dokumentacionit.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për nevoja të hetimit administrativ, vendosi të administrojë kryesisht në përputhje me nenin 136, pika 2 dokumentacionin e depozituar nga Partia Aleanca Arbënore Kombëtare pranë zyrës së protokollit të KQZ-së dhe dokumentacionin e depozituar pranë KZAZ-së.

KQZ, me vendimin me nr. 569 datë 19.05.2019, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" vendosi, njoftimin e KZAZ-së Maliq për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatëve për anëtar në këshillin e Bashkisë Maliq të Partisë Aleanca Arbënore Kombëtare (sipas modelit nr. 13 të depozituar në KQZ me nr. 3361 prot., datë, 13.05.2019).

Referuar dokumentacionit, Subjekti zgjedhor Partia Aleanca Arbënore Kombëtare për 4 emrat e zevendësuar të dërguara pranë KZAZ-së nuk ka paraqitur në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 8/1 të udhëzimit me nr.2 datë 29.01.2013, i ndryshuar. Për kandidatët për deputet në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, kandidatët për Kryetar Bashkie dhe kandidatët për Anëtarë në Këshillat Bashkiak në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, partia politike depoziton në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përveç dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, formularin e vetdeklarimit sipas modelit të miratuar në Kreun, III, pika 5 të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015".

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Partia Aleanca Arbënore Kombëtare nuk ka depozituar



në KQZ formularët e vetëdeklarimit për Këshillin e Bashkisë Maliq. Referuar nenit 5, pika 2, parashikohet se, "Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit.

Referuar pikës 5, neni 67 i Kodit Zgjedhor, numri i përgjithshëm i kandidatëve për një parti pjestare të koalicionit nuk mund të jetë më i vogël se sa gjysma e mandateve që zgjidhen në atë zonë zgjedhore. Lista e kandidatëve për anëtar në këshillin e Bashkisë Maliq të Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare, duke hequr 4 kandidatët të cilët nuk kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit është më i vogël se sa gjysma e mandateve që zgjidhen në atë zonë zgjedhore, në këto kushte nuk plotëson kriteret e nenit 67 të kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 73, pika 2, KZAZ-ja me nr. 68, me vendimin nr.10, datë 22.05.2019, ka vendosur mosregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Maliq, propozuar nga subjekti Aleanca Arbnore Kombëtare, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019. Vendimi nr. 10 datë 22. i mosregjistrimit i KZAZ-së me nr. 68 është në përputhje me Kodin Zgjedhor, Ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Për sa më sipër kërkesa ankimore e Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare është e pambështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 109 të Kushtetutës, nenet 68; 72; 73; 124, 143, pika 1, germa "b" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.4, datë 27.05.2019 të Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare dhe lënien në fuqi të vendimit nr.10, datë 22.05.2019 i KZAZ nr.68 "Për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Maliq, propozuar nga subjekti Aleanca Arbnore Kombëtare, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 725 i Vendimit Data 29.05.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 04, datë 29.05.2019, të paraqitur nga Partia
Aleanca Arbnore Kombëtare



Nr. 725 i Vendimit Data 29.05.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 04, datë 29.05.2019, të paraqitur nga Partia
Aleanca Arbnore Kombëtare